



DORËHEQJA: KUR, SI, DHE PSE?

Përgjegjësia politike si standard i domosdoshëm në shoqërinë maqedonase



FORUM FOR
REASONABLE POLICIES



FORUM FOR
REASONABLE POLICIES

Me qëllim të informimit sa më të mirë të publikut të kualifikuar, por edhe të qytetarëve, **Forumi i politikave të arsyeshme** filloi të publikojë një seri dokumentesh publike që përfshijnë tema lidhur me etikën në politikë, llogaridhënien e bartësve të funksioneve publike, si dhe korrupsionin në procesin zgjedhor.

Ne kemi për qëllim që, nëpërmjet shkëmbimit të praktikave më të mira, por edhe nëpërmjet të analizës thelbësore të kontekstit politiko-shoqëror maqedonas dhe veçorive të tij, të inicojmë diskutime për këto tema, të edukojmë, të informojmë dhe të ndikojmë për të ndryshuar, nëpërmjet ngritjes së vetëdijes së përgjithshme të elitave politike, por edhe të publikut më të gjerë (votuesit).

Kjo përmbledhje e politikave publike (policy brief) i përket çështjes së përgjegjësisë politike dhe se si është perceptuar ajo, si diçka e (pa) njohur dhe e artikuluar në skenën politike në Maqedoni. Brenda 30-vjetëve të pavarësisë së shtetit (1991-2021) ekzistojnë mjaft raste ku bartësit e funksioneve publike apo politikanët e zgjedhur në zgjedhjet parlamentare, për kryetar shteti ose vendore, kanë dhënë ose nuk kanë dhënë dorëheqje për shkaqe morale.

Vallë vendimi i tyre ka qenë i gabueshëm ose i drejtë është një temë që kërkon (ri) shqyrtim kritik e të arsyeshëm dhe mendimin e publikut, gazetarëve dhe vetë bartësve të funksioneve publike. Megjithatë, mbizotëron përshtypja se koncepti i përgjegjësisë morale apo politike nuk është kuptuar mjaftueshëm dhe qartë në opinionin maqedonas dhe besojmë se ky dokument do të kontribuojë në nxitjen e diskutimeve të mëtejme për këtë temë.

DORËHEQJA: KUR, SI, DHE PSE?

Përgjegjësia politike si standard i domosdoshëm në shoqërinë maqedonase

Mungesa e ndjenjës së përgjegjësisë politike nuk është njëfarë zbulimi ynë - maqedonas. Ky *institut* demokratik është i lidhur ngusht me zhvillimin politik dhe demokratik të një shteti, kulturën politike në një shoqëri, si dhe me rolin e qytetarisë vigjilente përkundrejt elitave politike (qëllimisht) jovigjilente. Thuhet shpesh se demokracia nuk ndërtohet brenda natës, dhe, se, duhet kohë, dije e vetëdije që ajo të rrënjohet në një shoqëri. Por, një qëndrim i këtillë ndonjëherë është alibi e përsosur për të mos bërë asgjë. Pikërisht rreziku për të mos bërë asgjë dhe thellimi i vazhdueshëm i problemeve si dhe kultura e mosndëshkimit janë temat që i ngërthen ky dokument. Si plotësim, kjo analizë synon të shpjegojë dhe të klasifikojë llojet e përgjegjësisë të një sistemi politik, dhe më pas të sugjerojë mënyra si të kahëzohet përgjegjësia e përcaktuar. Përfundimisht, qëllimi përfundimtar i këtij dokumenti është të ndihmojë që në mënyrë politike dhe etike të *normëzohen* (të përcaktohen) sjelljet e ardhshme të bartësve të funksioneve publike gjatë dështimeve të mëdha institucionale (tragjedi, fatkeqësi, dështime operationale, indikacione për korrupsion, etj.), si dhe të vendosen standardet e nevojshme për zgjidhjen etapore dhe sistemore të sfidave me të cilat përballet shoqëria dhe shteti maqedonas.

Përgjegjësia politike është pjesë e integruar dhe e pashmangshme e "standardit të artë" të demokracisë liberale. Po ta analizojmë këtë gjë më thellë, mund të thuhet gjithashtu se dorëheqja si një akt politik (edhe pse në radhë të parë paraqet një akt personal, dhe kjo është e rëndësishme!)¹ prek atributet më të mira të demokracisë: domethënë idenë e ndërrimit, idenë e papërsosmërisë së vazhdueshme dhe idenë e progresit (të ngadalshëm).

• Ideja e ndërrimit

Ky parim lidhet me faktin se askush nuk është i përjetshëm, as ai që e ka deponuar dorëheqjen, as kolektivi (qeveria) nëse bie si rezultat i një situatë të padëshirueshme dhe se gjithmonë diçka e perceptuar si e keqe mund të ndërrohet me një tjetër (edhe pse jo domosdoshmërisht më të mirë, por megjithatë tjetër). Problemi qëndron në atë se kur tjetri bëhet "i njëjtë si i pari". Atëherë ideja për përgjegjësi politike lëkundet deri në zhdukje. Pse duhet të largohem unë, kur të tjerët janë më të këqinj ose të paktën të barabartë me mua? Pse duhet t'u jap atyre diçka dhe ata prej asaj diçkaje ta bëjnë "asgjënë" e njejtë që e bëj unë? Pse unë duhet të largohem nga funksioni për diçka që e ka bërë dikush tjetër? Ai që është në pozitë më të ulët se unë, vartësi, drejtori, elektrikisti, shoferi, inspektori, doganieri etj.

Kjo mënyrë e të menduarit dhe të vepruarit e bën të pamundur institutin e përgjegjësisë politike. Në këtë rast, ai ose nuk ekziston, ose është plotësisht i zhvlerësuar, ose është i kamufluar pas ndonjë lloji tjetër presioni a manipulimi (të huajt i kanë bërë presion, e ka dhënë dorëheqjen, por nuk ia kanë pranuar, peticione për tërheqjen e dorëheqjes etj.) Përgjegjësia politike nënkupton besueshmëri (kredibilitet) personale, qëndrim personal ndaj pozicionit që mban dhe qëndrim personal ndaj vetes përmes syrit të votuesit dhe qytetarëve të tjerë që i përfaqëson, shërbëtor i qytetarit i të cilit je (civil servant). Pikërisht ideja e ndërrimit duhet të jetë parimi udhëheqës që zyrtarët të punojnë më mirë, me më shumë përgjegjësi dhe në të njëjtën kohë të jenë të vetëdijshëm se janë të ndërrueshëm dhe të zëvendësueshëm në çdo çast.

¹ Në një interpretim tjetër, lidhur me funksionimin e sistemit politik, përgjegjësia politike mund të merret si përgjegjësi e pushtetit ekzekutiv ndaj kuvendit, d.m.th. përgjegjësia e ekzekutivit ndaj legjislativit. Në suaza të këtij interpretimi, përgjegjësia konsiston kryesisht në pjesën e legjitimitetit që pushteti legjislativ (shumica parlamentare) i jep pushtetit ekzekutiv. Shkelja e këtij lloji të përgjegjësisë politike parimisht nënkupton që qeveria nuk gëzon besimin e shumicës në kuvend dhe shpesh herë përfundon me shpërbërjen e tij dhe zgjedhje të reja ose zgjedhjen e një shumice të re brenda kuvendit ekzistues. Megjithatë, ky interpretim nuk është objekt i kësaj analize.

• Ideja e papërsosmërisë së vazhdueshme

Ideja e papërsosmërisë së vazhdueshme (të përditshme), nga ana tjetër, nis nga premisa se në një sistem shoqëror, apo sistem politik në kuptimin e ngushtë të fjalës, udhëheqja e politikave publike është një histori e gjatë për papërsosmërinë e njeriut dhe aftësive të tij. Qeverisja është një proces i ndërlikuar, veçanërisht në kushtet e ndërlikimeve (komplikimeve) të vazhdueshme të shoqërive, të një numri të madh shërbimesh, inspektoratesh dhe agjencish që i përkasin një resori të caktuar dhe sfidave të vazhdueshme që i imponon epoka e re teknologjike. Nuk ekziston mbikontrollë mbi proceset, sado që të përpiqemi ta normëzojmë këtë. Dhe, për shkak se nuk ekziston një mbikontrollë, situatat e pakontrolluara (tragjeditë e mëdha në trafik, përmbytjet e anijeve, zjarret dhe stuhitë, skandalet e mëdha korruptive, etj.) dhe pasojat e tyre katastrofike duhet disi të kanalizohen përmes procesit politik. Dhe ato kanalizohen përmes dorëheqjeve dhe tërheqjes nga postet publike. Me këtë ne tregojmë se askush nuk është i përsosur dhe se askush as që mund të jetë i përsosur, por, njëkohësisht, që të gjithë duhet të jenë të gatshëm të paguajnë tagrën e papërsosmërisë. Ideja e papërsosmërisë është baza e idesë së ndërrimit, ashtu sikurse edhe demokracia që është më e mira nga të gjitha sistemet e papërsosura të qeverisjes.

• Ideja e progresit të ngadalshëm

Ideja e tretë, ajo e progresit të ngadalshëm, është me siguri aspekti më i rëndësishëm, më pozitiv dhe më kreativ i përgjegjësisë politike. Dhe kjo është se ajo tërheq (paraqet trigger) ose duhet të tërheqë, nëse dëshiron që të jetë e plotë, një sërë reagimesh institucionale të cilat duhet ta drejtojnë (adresojnë) rrënjësisht dhe detajisht problemin që ka shkaktuar dorëheqjen. Në këtë kontekst, dorëheqja është vetëm maja e ajsbergut, butoni i alarmit që thërret për veprim, siç janë: inspektimet, doganat, sistemet e kontrollit, komisionet e pavarura hetimore, mbikëqyrjet parlamentare, implikimet penale për përgjegjësit e drejtpërdrejtë sipas ligjit..., me një fjalë mobilizimi i përgjithshëm i të gjithëve që një gjë e tillë të mos përsëritet sërish. Këtu bëhet fjalë për një përfshirje të gjerë normëzimi të një sfere të caktuar (për shembull: transporti publik i pasagjerëve, mbrojtja nga zjarri dhe përmbytjet, parandalimi i praktikave korruptive, etj.) në mënyrë që të vendosen standarde dhe procedura të qarta për të shmangur të gjitha situatat e këtylla të mundshme në të ardhmen. Në thelb, bëhet fjalë për ndërtimin e institucioneve dhe procedurave të bazuara në përvojat e mëparshme (kryesisht negative), një lloj “ndërtimi në krizë”. Ky progres i ngadalshëm është progresi më themelor, megjithëse shpesh fitohet përshtypje se po na kushton shtrenjt.

Dorëheqja për arsye politike është shpesh shprehje e një akti të thellë moral. Ky akt është individual dhe lidhet me integritetin personal të bartësit të funksionit publik. Akti i dorëheqjes është vërtetim i përgjegjësisë morale të një zyrtari të caktuar për lëshimet (mangësitë) në punën e institucionit që ai drejton, pavarësisht se në çfarë niveli hierarkik ndodhin ato.

Përgjegjësia politike mund të ekzistojë edhe në situatat kur nuk ekziston faji ose qëllimi në aspektin juridik. Kjo nënkupton përgjegjësinë e zyrtarëve politikë për punë të pakënaqshme ose joefikase, mungesë të rezultateve të pritura dhe jokonsekuencë ose mangësi të tjera në suaza të përshkrimit të një funksioni të caktuar politik. Me një fjalë, përgjegjësia politike vjen si pasojë e perceptimit të performancës së dobët të bartësit të funksionit publik.

Kjo nënkupton që çdo zyrtar është personalisht përgjegjës (madje edhe pa fajin e vet) ndaj qytetarëve që e votuan në zgjedhje dhe që i besuan mandatin për të punuar për të mirën e përbashkët. Në kuptim të kufizuar (restriktiv), përgjegjësia politike në vendin tonë kuptohet si përgjegjësi para zgjedhësve nga fillimi deri në fund të mandatit, d.m.th. ndërmjet dy cikleve zgjedhore. Supozimi nënkupton që mandati i dhënë njëherë (në fillim) nga votuesit një elite të caktuar politike vlen deri në zgjedhjet e ardhshme (kur përsëri do të vihet në provë). Kjo mënyrë e të kuptuarit të përgjegjësisë nënkupton që zyrtarët i kanë duart të lira që të bëjnë çfarë të duan gjatë mandatit të tyre. Por, përgjegjësia politike nuk është kjo, ose thënë ndryshe, nuk është vetëm kaq. Duke qenë si përgjegjësi objektive pa faj dhe pa dashje, ajo është përgjegjësi për shkak të pasojave, të cilat nuk kanë lidhje me qëllimet aktuale ose të deklaruara të bartësit të funksionit publik. Përgjegjësia politike është rezultat i ndërprerjes së marrëdhënies së besimit midis votuesve dhe pushtetit, pavarësisht nga arsyeja për një shpëputje të kësaj ose vërtetimit të mëvonshëm të fajit.

Teza se bartësi i funksionit publik është në pozitë më të mirë për të pastruar rastin dhe për të eliminuar lëshimet në portofolin e tij/saj gjithashtu është problematik. Me fjalë të tjera, edhe udhëheqësit më të mirë, kur i ndodh ndonjë lëshim në resorin e tij, ai nuk është në gjendje ta zgjidhë problemin në mënyrë të paanshme. Ai thjesht perceptohet nga publiku si pjesë e *përgjegjësisë komanduese* dhe një mbrojtës i mundshëm i vartësve që mund të jenë drejtpërdrejt përgjegjës për një situatë / fatkeqësi / lëshim. Edhe në këtë rast tregohet se mosdhënia e dorëheqjes me shpjegimin se “më parë duhet të sqarohen gjërat” gërryen edhe më tepër zinxhirin e besimit mes qytetarëve dhe pushtetit.

● Sqarime kuptimore

Nocioni përgjegjësi në gjuhën angleze shprehet me anë të dy termave të ndryshëm: responsibility & accountability. Edhe pse të dyja mund të përkthehen si përgjegjësi, ato dallohen nga ana kuptimore. Përgjegjësia në kuptimin e responsibility i referohet kompetencës, thirrjes për përgjegjësi, mandatin për të kryer një punë ose funksion të caktuar, besimit të autoritetit ose një fuqie të caktuar për të kryer punët. Përgjegjësia në këtë kuptim lidhet shprehimisht me mandatin, i cili fillon në një moment të caktuar dhe përfundon në momentin kur cenohet besimi ose me përfundimin e mandatin, d.m.th. në zgjedhje.

Përgjegjësia në kuptimin e accountability tek ne përkthehet më saktësisht si llogaridhënie. Llogaridhënie në kuptimin e detyrimit për llogaridhënien, vazhdimisht duhet shpjeguar vendimet ose politikat e caktuara, për të justifikuar punën dhe për të matur performancën e zyrtarit. Pra, dorëheqja si akt personal mund të ndodhë në rast të llogaridhënies së pamjaftueshme të bartësit të funksionit publik për një situatë konkrete, ose si rrjedhojë e më shumë jokonsekuencave konkrete në punë.


Situatat dhe sfidat e përditshme me të cilat përballen zyrtarët publikë lënë hapësirë për një interpretim elastik të përgjegjësisë politike (që mund të kuptohet në mënyra të ndryshme). Domethënë, ajo vjen gjithmonë shumë shpejt, papritur, e padëshiruar. Prandaj, përvojat e mira të demokracive të zhvilluara liberale na mësojnë se si t'i përgjigjemi pyetjeve kur, si dhe pse duhet të jepet dorëheqja?

KUR? Kjo është një pyetje delikate sepse ngre dilema të ndryshme. Pse do të jepte dorëheqjen një ministër objektivisht i mirë nëse nuk është drejtpërdrejt fajtor për një ngjarje/fatkeqësi në resorin e tij? Pse qytetarët do të duhet të privohen nga shërbimet e tij/saj si shërbëtor i qytetarit nëse një prej drejtorëve apo udhëheqësve vartës të tij/saj nuk ka qenë i përgjegjshëm ose ka gabuar?

Këto janë në fakt dilema të rrejshme. Përgjigja se kur duhet dhënë dorëheqja është e thjeshtë: menjëherë, pa u menduar fare! Çdo zvarritje është blerje kohe dhe zbehje e qëllimit parësor të dorëheqjes, përkatësisht vendosjes së një standardi në të ardhmen dhe zgjidhjes afatgjatë të çështjes/problemit.

SI? Në mënyrën që sjell progres në fushën që duhet rregulluar. Procesi i dorëheqjes dhe efekti i tij duhet të jetë në lidhje me përgatitjen e trajtimit të problemit në të ardhmen. Në të kundërtën, dorëheqja do të jetë vetëm një kockë e hedhur për publikun gjithmonë të uritur, por karvani i papërgjegjshmërisë do të vazhdojë edhe më tej. Dorëheqja duhet të shoqërohet me një plan të qartë për zgjidhjen e simptomës së problemit, një plan që do të ketë fillimin dhe mbarimin e tij, ku, ndërkohë, mund të ketë edhe dorëheqje e shkarkime të tjera apo përgjegjësi penale në tërë “vijën komanduese”. Ky plan duhet të ketë përfundimin e tij me të cilin do të informohet publiku se shkaqet e situatës/problemit konkret janë zbuluar dhe adresuar dhe se situata të tilla nuk pritet të ndodhin në të ardhmen. Në këtë mënyrë rivendoset zinxhiri i besimit ndërmjet qytetarëve dhe elitave politike.

PSE? Sepse vetëm me marrjen e përgjegjësisë politike do të mund të lëmë “guralecë” në rrugë që do të jenë shembull për të tjerët. Jo vetëm si nuk duhet bërë, por më tepër se si duhet bërë! Dorëheqja është një akt që duhet të na mësojë, të na përmirësojë, të vendosë standarde. Përfundimisht, dorëheqja ofron rrugëdalje të lehtë me “fytyrë të pastër” të zyrtarit konkret dhe realisht ofron hapësirë për t'u rikthyer në poste publike në të ardhmen, ndonjëherë edhe në derë të madhe.



Bazuar në të dhënat e lartpërmendura, në raste të lëshimeve të mëdha gjatë udhëheqjes së një resori apo institucioni të caktuar, ekzistojnë tre hapa ose udhëzime themelore që duhet t'i bëjë çdo bartës i postit publik:

- Informo qartë dhe drejt publikun se diçka nuk është në rregull me funksionimin e sistemit, se ka ndodhur një tragjedi, ose është bërë njëfarë lëshimi i madh gjatë punës. Bëjeni pa asnjë përpjekje për të mbuluar faktet apo për të maskuar problemin. Fshehja e argumenteve në mënyrë të paarsyetuar vjen gjithmonë më vonë me *faturë* të rëndë politike.

- Mos ua ngarko fajin të tjerëve brenda institucionit tuaj, veçanërisht jo vartësve. Në afat të gjatë kohor, kjo mund të ketë një efekt shumë negativ në reputacionin e institucionit dhe bartësit të tij. Mangësitë dhe përgjegjësia e mundshme ligjore duhet të përcaktohen më vonë, në mënyrë të paanshme dhe të pavarur.

- Jepni (depononi) menjëherë dorëheqjen tek eprori, me shpresën se do të pranohet. Ky moment është delikat, sepse në situata të caktuara mund të mos pranohet dorëheqja për arsye të caktuara. Varësisht nga përmasat e problemit, nga natyra e problemit dhe nga perceptimi fillestar i përgjegjësisë politike apo juridike, nijansohet vetë akti i dorëheqjes. Përvoja tregon se është gjithmonë më mirë të japësh dorëheqjen në mënyrë të parevokueshme ose të këmbëngulësh për dorëheqje. Në situata të caktuara kur publiku është i gatshëm të falë ose të tregohet i butë, ose kur problemi qëndron objektivisht përtej pushtetit të detyrës, mund të mos pranohet dorëheqja. Por kjo gjë duhet të ndodhë vërtet rrallë, sepse ka rrezik që në të ardhmen kjo mund të lërë njollë serioze në legjitimitet.

Nga e gjithë kjo që u përmend më lart, mund të veçohen disa rekomandime që do të përmirësonin ndjeshëm sistemin e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së bartësve të funksioneve publike, si dhe vendosjen e standardeve në të ardhmen për progresin në fushën e cila rregullohet:

- Përgjegjësia politike duhet të jetë strumbullar rreth të cilit do të riparohet kultura politike në vend. Kjo gjë nënkupton, nevojën e vendosjes **së standardeve të larta, të padyshimta dhe të qarta** për të qenë imperativ i çdo pushteti ekzekutiv të ardhshëm dhe së paku parim i heshtur i sjelljes për të gjithë bartësit e funksioneve publike.

- Politikanët, gazetarët, publiku të bëjnë **një dallim të qartë ndërmjet përgjegjësisë politike/ morale dhe ligjore ose administrative**. Turbullimi (jo) i qëllimshëm i këtyre koncepteve e bën të mundur kulturën e mosndëshkimit dhe llogaridhënies së bartësve të funksioneve publike. Të përsërisim, përgjegjësia politike ka pikënisje etike dhe nuk lidhet domosdoshmërisht me llojet e tjera të përgjegjësisë. Mu për faktin se nuk është e lidhur, ajo ekziston si e vetme, e izoluar nga implikimet e tjera (ligjore dhe të tjera) dhe për këtë arsye duhet trajtuar si një akt i ndërprerjes së besimit midis qytetarëve/votuesve dhe bartësit të funksionit publik.

- **Partitë politike** të përfshijnë në statutet ose dokumentet e tyre programore se përgjegjësia politike do të jetë parimi kulmor ose i rëndësishëm i veprimit të tyre. Në këto dokumente duhet të bëhet një dallim i qartë ndërmjet përgjegjësisë politike (morale) dhe llojeve të tjera të përgjegjësisë. Në të njëjtin drejtim, nevojitet të plotësohet “Kodi i etikës për anëtarët e Qeverisë si dhe për bartësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria” me një saktësim të qartë të dispozitave për përgjegjësinë politike.

- **Përgjegjësia politike** është personale dhe duhet trajtuar si e tillë. Në parim, një zyrtar epror nuk ka të drejtë të MOS pranojë aktin personal të parashtrimit të përgjegjësisë politike. Një mospranim i tillë pothuajse rregullisht çon në shkeljen e legjitimitetit të një elite të caktuar qeverisëse dhe krijon një precedent të gabuar për të ardhmen.

- Pas çdo dorëheqjeje për arsye politike/morale (veçanërisht në raste fatkeqësish të mëdha apo lëshimesh të mëdha në funksionimin e një institucioni), çdo qeveri duhet të angazhohet për krijimin e një **trupit operativ të pavarur** (task force) me një afat të dhënë konkret brenda të cilit do të shqyrtohen të gjitha detajet dhe do të japë rekomandime të detyrueshme për një zgjidhje sistematike të problemit në fjalë. Prej raportit të trupit operativ pritët të jepen edhe udhëzime edhe indikacione se kur dhe në cilën pikë sistemi ka dështuar, gjë që do të rezultojë në nevojën për një lloj tjetër përgjegjësie (ligjore, administrative, etj.). Raporti i ekspertëve nga organi i pavarur më pas duhet t'u dorëzohet të gjitha palëve potenciale të interesit: zyrtarëve të lartë politikë, kuvendit, prokurorisë, organizatave profesionale joqeveritare (të ashtuquajturat monitoringu civil), inspektorateve, shërbimeve teknike dhe institucioneve të tjera përkatëse.

Perceptimi i përhapur në publikun e gjerë se bartësit e funksioneve publike nuk kanë marrëdhënie të drejtë ndaj përgjegjësisë politike na tregon se kemi një rrugë të gjatë për të ecur drejt një shoqërie të dëshiruar për llogaridhënie dhe përgjegjësi të elitave politike. Nga kjo rrugë duhet të nisemi, sepse nuk ka kthim prapa.

• Referencat

Guerin B, McCrae J and Shephard M, *Accountability in Modern Government: What are the issues?* Institute for Government, 2018, www.instituteforgovernment.org.uk/publications/accountability-modern-government-issues

Dobel, P. *The Ethics of Resigning*. Journal of Policy Analysis and Management, Vol. 18, No. 2, 245-263. 1999

Aucoin P and Heintzman R, 'The dialectics of accountability for performance in public management reform', *International Review of Administrative Sciences*, 2000, vol. 66, pp. 45-55.

Ottmann, H., *Odgovornost*, Politicka misao. Vol. XXVIII {1991}, No. 3. Slr. 17D-176

Ricarda Roos, S., Babic, I. *Vladavina prava- Odgovornost i kontrola vlasti*, Fondacija Konrad Adenauer Beograd, 2009
https://www.kas.de/documents/252038/253252/7_dokument_dok_pdf_18618_1.pdf/13d15b0a-2f8a-20bb-6350-48bb0cc66af4?version=1.0&t=1539661491240

Дојче Веле, *За политичка одговорност треба политичка култура*, 04.03.2015
<https://p.dw.com/p/1Ekh1>

Влада на Република Северна Македонија, *Кодекс за етичко однесување за членовите на Владата и носителите на јавни функции именувани од страна на Владата*, 2020, https://vlada.mk/sites/default/files/img/etichki_kodeks.pdf



**FORUM FOR
REASONABLE POLICIES**

Forumi i politikave të arsyeshme është organizatë ekspertësh (think-tank), e themeluar në vitin 2017 me qëllim të:

- Krijimit të bazës për zhvillim të qëndrueshëm në fushën e demokracisë, kulturës dhe ekonomisë;
- Promovimit të shoqërisë që bazohet në arsyen, si bazë më e qëndrueshme për ndërtimin e politikave të përbashkëta;
- Vënies në qarkullim (lansimin) e platformës për afirmimin e parimeve dhe politikave reale, të prekshme, të mirëkuptuara, pa marrë parasysh a janë të njohura dhe të përditësuara në çastin e shqiptimit të tyre;
- Kundërshtimit të kompromiseve dhe konsensusit të rremë që ofrojnë zgjidhje për qetësimin e situatës, ndërkaq në thelb thellojnë ndarjet në shoqëri dhe kërcënojnë përparimin afatgjatë;
- Sfidimit dhe rishqyrtimit në mënyrë kritike të pozicioneve, të politikave dhe të qëndrimeve të çdo institucioni politik dhe ekonomik, veçanërisht të atyre që janë jodemokratike ose demokratike problematike.



www.frp.mk
frp@frp.mk

© 2022 Forumi i politikave të arsyeshme